

**STATUTI I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
"NOVA SERVICE ALBANIA" Sh.P.K**

Sipas ligjit Nr.° 9901 Date 14.04.2008 "Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare", dhe ne perputhje me Ligjet qe operojne ne Republiken e Shqiperise,

**LUNERTI ROBERTO** lindur me 22.05.1961, ne Milano, banues ne Morlupo, Italia, shtetas Italian, identifikuar me karte ID No.AY1275948, e vlefshme deri me 22.05.2027, me pergjegjesi te plote per te vepruar.

**QUARTUCCIO GIUSEPPE** lindur me 16.11.1968, ne Firenze, banues ne Ardea, Itali, shtetas Italian, identifikuar me karte ID No. AU9993583, e vlefshme deri me 22.05.2027, me pergjegjesi te plote per te vepruar.

**CASBARRA LUIGI** lindur me 23.09.1992, ne Beneveto, Itali, banues ne Aprilia, shtetas Italian, identifikuar me karte ID No. AO9834154, e vlefshme deri me 23.09.2018, me pergjegjesi te plote per te vepruar.

**CASBARRA GIUSEPPE ANTONIO LORENZO** lindur me 10.08.1963, ne Manfredonia, Itali, banues ne Aprilia, shtetas Italian, identifikuar me karte identiteti No. AO 9834155, e vlefshme deri me 10.08.2018, me pergjegjesi te plote per te vepruar.

Sot me 22 Mars 2018 vendosin te themelojne Shoqerine "NOVA SERVICE ALBANIA" Sh.P.K.

***Neni 1***

***Emertimi i shoqerise***

Shoqeria do te mbaje emrin "NOVA SERVICE ALBANIA " Sh.P.K. Emertimi tregetar do te jete "NOVA SERVICE ALBANIA"

***Neni 2***

***Forma Ligjore e Shoqerise***

Shoqeria do te kete formen e saj Ligjore, "Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar" sipas Ligjit Nr. 9901 Date 14.14.2008 "Per tregetaret dhe Shoqerite Tregetare" bashke me ndryshimet perkatese. Shoqeria mund te ndryshoje formen e saj ligjore me vendim te ortakeve themelues.

***Neni 3***

***Afati***

Veprimtaria e kompanisë do të fillojë në datën e regjistrimit të saj prane Qendres Kombetare te Biznesit. Aktiviteti i shoqërisë do të jete pa afat.

***Neni 4***

***Selia***

Shoqeria do tekete seline e saj ne adresen: Rr. Tish Daija, Komuna e Parisit, Kompleksi Kika 2, Shkalla 3, Hyrja 1, app 13, kati 3, Tirane.

Shoqeria mund të kryejë e të transferojë, apo të menaxhojë qendra administrative, seli, filiale, agjensi dhe zyra në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë vendit, me vendim të ortakeve themelues. Shoqeria ofron mundësinë e pjesëmarrjes në shoqëri të tjera në të ardhmen të cilat do të krijojnë aktivitete në Republikën e Shqipërisë dhe/ose jashtë saj, me vendim të asamblese së ortakeve themelues.

#### ***Neni 5***

##### ***Objekti***

Shoqeria ka për objekt veprimtaritë e mëposhtme:

- Sigurimi i shërbimeve për: studime, zyra, banka, objekte publike, institucione industriale dhe paleve të treta të çdo lloji dhe natyre dhe entitete në veçanti në lidhje me makineri dhe pajisje elektronike dhe të ndryshme për zyra, orendi dhe artikuj shkrimi për zyra në përgjithësi;
- blerjen, shitjen, marketingun në të gjitha format e tij, qira, mirëmbajtje, riparim dhe asistencë për produktet e përshkruara më sipër;
- transportin për palët e treta dhe për vete;
- shërbime pastrimi në përgjithësi;
- instalimi dhe mirëmbajtja e impianteve në përgjithësi (elektrike, hidraulike, transmetimi i të dhënave, etj.);
- prodhimi dhe asistencë e programeve kompjuterike.

Për të arritur qëllimin e shoqërisë dhe pa e zgjeruar atë, mund të kryejë të gjitha veprimet për pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme dhe çdo aktivitet tjetër të nevojshëm ose të dobishëm, ose dhënie me qira, kreditë dhe financiare, marrje ose dhënie me qira të pjesëve të shoqërisë, objekti i të cilave është i ngjashëm ose i njejtë.

#### ***Neni 6***

##### ***Kapitali***

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë 6.500.000 Lek i përbërë si vijon:

LUNERTI ROBERTO zotëues i një kuote të barabartë me 25% të kapitalit themelues të shoqërisë, ekuivalente në vlerë nominale me 1.625.000 leke.

QUARTUCCIO GIUSEPPE zotëues i një kuote të barabartë me 25% të kapitalit themelues të shoqërisë, ekuivalente në vlerë nominale me 1.625.000 leke.

CASBARRA LUIGI zotëues i një kuote të barabartë me 25% të kapitalit themelues të shoqërisë, ekuivalente në vlerë nominale me 1.625.000 leke.

CASBARRA GIUSEPPE ANTONIO LORENZO zotëues i një kuote të barabartë me 25% të kapitalit themelues të shoqërisë, ekuivalente në vlerë nominale me 1.625.000 leke.

#### ***Neni 7***

##### ***Organet Drejtuese dhe vendimtarë***

Organi vendimtarës i shoqërisë është asambleja e ortakeve themelues të shoqërisë, e cila drejton aktivitetin e shoqërisë nëpërmjet vendimeve të tij.

- a. përkufizimi i politikave të kompanisë
- b. ndryshon dhe/ose modifikon statutin e shoqërisë
- c. emeron dhe shkarkon administratoret
- d. emeron dhe shkarkon auditoret
- f. percakton nxitjen e personave në paragrafin C dhe D.
- e. ndryshon seline
- f. ndryshon emrin e shoqërisë
- g. rikapitalizon shoqërinë, duke rritur dhe/ose zvogëluar shoqërinë

- k. ndarjen ose anulimin e kuotes
- h. riorganizimin ose prishjen e shoqerise
- i. miraton rregulloren procedurale për mbledhjen e mbledhjes tye ortakeve te shoqerise.
- j. te tjera te parashikuara nga ligji ose statuti

## **Neni 8**

### **Administrimi**

#### *I. Detyrat dhe Pergjegjesite e adminsitratorit te shoqerise do te jene:*

- *Te përfaqësoje shoqërinë para palëve të treta dhe para gjykates, per ceshtje administrative dhe fiskale, në çfarëdo shteti, niveli a vendndodhje, me te drejten per të nënshkruar cdo akt ne sherbim të procedures per pefaqesim, mbrojtje dhe/ose ankesë, pyetje, deklaratë, për çdo rast, duke propozuar apo marre masa me qellim mbrojtjen dhe pafajesimin, duke përmbushur formalitetet relative; me të drejtën për t'u zëvendësuar duke kufizuar gjykimet individuale, nga avokatët e tij të posaçëm për ushtrimin e kompetencave që gezon;*
- *Të nënshkruajë deklarata dhe ankesa ne zbatim te detyrimeve fiskale dhe monetare me te drejte per te nenshkruar te gjitha aktet ne kete linje, deklarata, vertetime, dhe cfaredolloj akti apo certifikate;*
- *Te delegoje dhe te leshoje prokure për punonjësit e kompanisë dhe palëve të treta, me qellim mundesimin detyrave te caktuara ne emër dhe për llogari të shoqerise, duke nenshkruar per llogari te shoqerise.*
- *Menaxhon aktivitetet e kompanisë dhe mbikëqyr veprimtarinë e strukturave të shoqërisë;*
- *Te prezantoje aktive dhe pasivet e shoqërisë tregtare në Shqipëri dhe jashtë vendit në marrëdhëniet me Administratorin e shoqerise ne shtetin perkates, me autoritetet rajonale dhe lokale, me organet publike dhe private, para çdo autoriteti administrativ, tatimore dhe gjyqësore, të zakonshme dhe të veçanta;*
- *Te nenshkruaje, ndryshoje kontratat e qerse apo te aseteve te palevizshme per kohezgjatjen duke mos tejkaluar afatin 6 vjetor, te zgjidhe kontrata ne fuqi me vendim te asamblese.*
- *Të përcaktojë, modifikojë, ndërpresë kontratat e blerjes për materialet e tregtueshme, të prodhuara në përputhje me udhëzimet dhe buxhetin e miratuar nga asamblea;*
- *Te Përcaktojë, modifikojë, të ndërpresë kontratat e shitjes për shuma deri në 15,000.00 € në përputhje me udhëzimet dhe me buxhetin e miratuar nga asambela e shoqerise, duke ndjekur udhëzimet e ortakeve ne pergjithesi dhe çdo udhëzim përkatës për zbritje dhe/ose listën e çmimeve;*
- *Të nenshkruaje kontrata shkembimi të mjeteve dhe pajisjet e transportit ne pergjithesi duke kerkuar paraprakisht pelqimin e asamblese, te lira nga nga të gjitha obligimet dhe detyrimet sipas regjistrir te barres siguruese;*
- *Të nenshkruaje, të modifikojë dhe të prishe kontratat e sigurimit për çmime deri në 1,500.00 € në vit;*
- *Të nenshkruajë, modifikojë dhe prishe kontratat për transportin, ruajtjen dhe ofrimin e shërbimeve publike;*
- *Te nenshkruaje, modifikoje dhe të prishe kontratat e shërbimeve, takimet profesionale dhe konsultime deri në një maksimum prej 2,000.00 EUR në vit duke perfshire ketu edhe zera te ndryshem te sherbimeve per te njejtin qellim.*
- *Te realizoje, te nenshkruaje transaksione ligjore gjyqësore dhe ceshtje te tjera per tarifa qe nuk tejkalojne € 5,000.00 duke informuar ortakun dhe duke e mbajtur te informuar ne vijimesi.*
- *Te kryeje të gjitha transaksionet bankare dhe financiare të zakonshme dhe te vecanta;*

- Te ndjeke te gjitha praktikat ne lidhje me autoritetet shqiptare dhe te huaja ne lidhje me kerkesat e importit dhe eksportit, te shkarkoje mbetjet, dhe te nenshkruaje cdo lloj dokumenti qe shihet e nevojshme bazuar ne pergjegjesite dhe kompetencat e veta.
- Të kërkojë kredi te çdo lloji dhe entiteti dhe të tërheqin shumat dhe vlerat, duke lene spjegime te mjaftueshme dhe te dokumentuara, si për individët ashtu edhe për entet publike;
- Te perpiloje cdo akt ne lidhje me ndjekjen e shit-blerjeve te shoqerise, te menaxhoje raportet me entet dhe nenkontraktoret.
- Te punesoje dhe largoje punonjes te cfaredolloj niveli duke perfshire edhe nivelin drejtues ne perputhje me kriteret e pergjithshme dhe buxhetin e miratuar nga asamblea, si dhe ne zbatim te plote te kodit te punes dhe dispozitat ligjore ne fuqi.
- Përfaqësimi i kompanisë para sindikatave dhe shoqatave tregtare; Te përfaqësojë Shoqërinë në gjykimet që kanë të bëjnë me punëtorët, duke përcaktuar gjithashtu çdo mosmarrëveshje punësimi në një mënyrë kalimtare;
- Të regjistrohet ne Dhomën e Tregtisë dhe në organe dhe zyra të tjera publike dhe private lidhur me detyrimet e vendosura ndaj kompanisë sipas ligjeve dhe rregulloreve ne fuqi;
- Koordinimin e llogarive mujore në bazë të shitjes me ekonomistin e brendshëm i cili kujdeset për të koordinuar me konsulente të jashtëm përgjegjës për shërbimet e lidhura;
- Përgatitja e dokumentacionit administrative të stafit, pa kufizim, listprezencat, si dhe dispozitat financiare për përgatitjen e listës së pagave, të autorizojë udhërat e shërbimit dhe rimbursimin e shpenzimeve brenda kufijve të autorizuar sipas buxhetit te miratuar nga asamblea e ortakeve themelues te shoqerise;
- Përgatitja e raporteve të detajuara për secilën nga aktivitetet e kompetencës në baze javore;
- Përgatitja e raporteve të detajuara që tregojnë trendet ekonomike, fiskale, kontabël dhe komerciale në baza mujore;
- Zhvillon tregun për shitje dhe negociacion me blerësit e mundshëm;
- Monitoron tenderët publikë dhe / ose privatë, kryen negociata private për rekrutimin e kontratave që lidhen me qëllimin e shoqerise me administratat publike dhe private;
- Monitoron dhe raporton për Mbledhjen e Asamblese trendin e konkurrencës në veçanti në lidhje me produktin, rregullat teknike, të sigurisë, cilësi dhe çmime, përfshirë lehtësimin e çështjeve të borxhit, dhe/ose perditesimin e politikës tregtare në diskrecionin e vetëm të Asamblese se ortakeve te themelimit te shoqerise;
- Administratori i vetëm është përgjegjës për menaxhimin e privatësisë;
- Admistratori i vetëm është në dispozicion për të udhëtuar në Shqipëri dhe jashtë saj ne shërbim te realizimit te objektit te shoqerise;
- Aktivitete të tjera të çfarëdo natyre ne shërbim te realizimit te objektit të saj në kufirin buxhetor te miratuar nga asamblea e ortakeve te shoqerise, ose, kur është e nevojshme, si rezultat i kërkesës së shprehur nga vete admistratori.

Konfirmimet per sa limituar me siper, do te konsiderohen te vlefshme vetem me autorizim ne forme te shkruar nepermjet e-mail ose me vendim te ortakeve te shoqerise. Autorizimi duhet te bashkelidhet cdo kontrate te nenshkruar per vlera qe kalojne limitet e caktuara me siper. Do te konsiderohet e vlefshme edhe nje konfirmim me email sipas kerkesees se komunikuar nga admistratori i vetem i shoqerise edhe pa qene e nevojshme thirrja e asamblese dhe pa prezencen e te gjithë ortakeve themelues ne email ne grup ose edhe vecmas prej secilit me vete.

- II. Shoqeria do te kete administratorin e saj te vetem, znj. **Ariana Nepravishta**, lindur me 01.04.1971, ne Vlore, nenshtetase shqiptare, identifikuar me karte identiteti nr. 027689475, me nr. Personal identifikimi H15401193N, e vlefshme deri me 04.10.2019, me pergjegjesi te plote per te vepruar, per 5 vjet me te drejte rinovimi.

Viti financiar i shoqërisë është nga 1 Janari dhe mbaron më 31 Dhjetor. Përbashimisht, viti i parë i veprimtarisë së shoqërisë do të llogaritet nga data e regjistrimit të shoqërisë dhe do përfundojë më 31 dhjetor.

**Neni 10**

***Të ardhurat, Dividentët***

Shoqëria do të krijojë fonde rezervë për realizimin e aktivitetit të shoqërisë. Fitimi pas përfundimit të vitit financiar dhe pas pagimit të tatimit, mund të shpërndahet tek ortakët me vendim të asamblese së ortakëve themelues të shoqërisë.

**Neni 11**

***Shpërndarja dhe Likuidimi***

Shpërndarja e shoqërisë mund të bëhet për sa vijon:

- a. Fundi i kohëzgjatjes së aktivitetit të parashikuar në aktin e themelimit;
- b. Me vendimin e asamblese së ortakëve themelues të shoqërisë;
- c. Hapja e një procedure falimentimi;
- d. Nëse nuk kryen aktivitete tregtare për dy vite të vazhdueshme dhe pse nuk është kërkuar pezullimi i shoqërisë në QKB;
- e. Me vendimin e gjyqtarit;

Likuideuesi, raporton për statusin e aktiveve dhe detyrimeve të kompanisë në operacionet e mëtejshme të shlyerjes dhe kohën e nevojshme për mbylljen e procesit. Në fund të këtij procesi, ortakët, do të informohet për balancën përfundimtare dhe mbylljen e procedurës së likuidimit.

**Neni 12**

***Klauzola mbyllëse***

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë veprimtarisë së shoqërisë, nëse nuk zgjidhen në mënyrë miqësore, palët drejtohen organeve kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, përveç rasteve kur kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve sipas ligjit është Sistemi Gjyqësor Shqiptar.

(Emer Mbiemer / Nenshkrimi)

Perktheu:  
Edmir Dano

Soci della Societa

QUARTUCCIO GIUSEPPE

LUNERTI ROBERTO

CASBARRA LUIGI

CASBARRA GIUSEPPE A.L.

A: Neprawalko  
A: Neprawalko